

Врз основа на член 55 став 1 од Законот за организација и работа на органите на државната управа („Службен весник на Република Македонија” бр. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 и 51/11) и („Службен весник на Република Северна Македонија” бр.96/19 и 110/19), како и врз основа на член 22 и член 25 од Законот за средно образование („Службен весник на Република Македонија“ бр. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 и 64/18) министерот за образование и наука донесе скратена наставна програма по наставниот предмет хемија за IV (четврта) година на средното стручно образование со четиригодишно траење на струка **текстилно-кожарска - сите образовни профили** за учебната 2020/21 година

1. Hyrje

Programi i shkurtuar mësimorë në lëndën e *kimisë* për vitin e IV- (katër) në arsimin e mesëm profesional me kohë zgjatje katërvjeçare në drejtimet **tekstil- lëkur -të gjithë profilet arsimore** bazohet në qëllimet/ rezultatet e pritura të parashikuar në programin mësimor për lëndën mësimore që realizohet në mënyrë të rregullt në pajtueshmëri me planin mësimor të përcaktuar.

Me programin e shkurtuar mësimor verifikohen tema të caktuara dhe njësi mësimore që duhet të realizohen në 145 ditë mësimore, me çka ruhet fondi javor i orëve të parashikuar me programin e rregullt, gjegjësisht për lëndë mësimore me 2 orë në javë janë paraparë 58 orë me programin e shkurtuar.

Arsimtari gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet/rezultatet e pritura, nocione të caktuara, metoda dhe aktivitete të përcaktuara në programin e rregullt mësimor.

2. Pasqyra e temave dhe njësive mësimore

Tema 1: BAZAT E BIODIMISË (26orë)

Njësitë mësimore:

- Hyrje në biokimi
- Karbohidratet (nocioni, përbërja, klasifikimi, të gjeturit, biosinteza, roli)
- Përfaqësuesit më të rëndësishëm të monosakarideve.
- Oligosaharidet.
- Polisaharidet.
- Nocioni, klasifikimi dhe roli i lipideve .

- Përfaqësuesit më të rëndësishëm të lipideve (yndyrnat dhe vajrat).
- Të gjeturit, rëndësia dhe ndarja e vitaminave .
- Vitaminat e tretëshme në vaj.
- Vitaminat e tretëshme në ujë .
- Nocioni, struktura dhe rëndësia e proteinave .
- Vetitë fizike të proteinave .
- Vetitë kimike të proteinave.
- Nocioni, ndarja dhe nomenklatura e enzimeve.

Tema 2: ELEMENTET, KOMPONIMET DHE REAKSIONET KIMIKE (20orë)

Njësitë mësimore:

- Nocioni i mekanizmit të reaksioneve organike .
- Tipet më të rëndësishme të reaksioneve organike.
- Ndërtimi i mbështjellsit elektronike dhe konfiguracioni elektronik i elementeve
- Konfiguracioni elektronike dhe struktura e sistemit e periodik të elementeve.
- Periodiciteti i ndryshimit të vetive të elementeve dhe substancat e tyre elementare .
- Oksidet
- Acidet
- Hidroksidet
- Kriprat
- Komplekset

Tema 3: LLOGARITJE KIMIKE (12orë)

Njësitë mësimore :

- Madhësitë fizike dhe njësitë. Sasia e substancës, mol dhe madhësitë molare .
- Detyra nga sasia e substancës dhe madhësitë molare .
- Llogaritje në bazë të formulave kimike .
- Llogaritje në bazë të barazimeve kimike.
- Llogaritja e përbërjes kuantitative të tretësirave.

3. Rekomandimet didaktike

Në programin e shkurtuar mësimor përfshihen tema dhe përmbajtje mësimore të caktuara në programin e rregullt që janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën dhe që formojnë një tërësi logjike. Në pjesën *Pasqyrë e temave dhe njësive mësimore* renditen temat e përcaktuara nga programi i shkurtuar dhe njësitë mësimore që i referohen zhvillimit të përmbajtjeve të reja mësimore.

Për shkak të kohëzgjatjes së shkurtuar të orës, rekomandohet që arsimtari në harkun kohor të caktuar ta organizojë orën me një pjesë të përshtatshme hyrëse, pjesën kryesore dhe pjesën përfundimtare. Këto tre elemente të secilës orë mësimore duhet të përqendrohen në objektivat kryesore të të nxënit, ato duhet të jenë të lehta për tu kuptuar dhe të ofrojnë një mundësi për praktikë shtesë të përmbajtjes së paraqitur. Në fund të secilës orë mësimore, mësimdhënësi duhet ta përmbledh atë me theks të përmbajtjes së re dhe rekomandim për mësim dhe praktikim të mëtejshme e të pavarur. Gjithashtu, mësimdhënësi duhet të jetë i kujdesshëm në prezntimin e përmbajtjes së re në mënyrë që ajo t'i përshtatet të gjitha stileve të të mësuarit: dëgjimore, vizive, të kapshme dhe kinestetike, në mënyrë që secili nxënës përmbajtjen e prezentuar të mund ta kuptojë dhe përvetësoj më lehtë dhe më shpejtë.

Për secilën temë, është dhënë numri i përgjithshëm i orëve që do të realizohen. Duke pasur parasysh njësitë e dhëna mësimore të cilat dedikohen për përpunim të përmbajtjeve të reja mësimore, , numri i mbetur i orëve në kuadër të temave, mësimdhënsi i planifikon, organizon, dhe i realizon si orë për përsëritje, përforcim, ushtrime, kontrolimin e diturive të nxënësve , sistematizim, eksperimentim, hulumtim, etj. Gjithashtu, një pjesë e këtyre orëve mund të përdoret për realizimin e një përmbajtje të caktuar mësimore gjatë dy orëve mësimore, e cila sipas vlersimit të mësimdhënsit, kërkon një kohë më të gjatë për realizim.

Në temat e përmendura, sipas vlersimit të arsimtarit, disa nga përmbajtjet mund të realizohen në disa orë mësimore, përfshirë edhe orët e ushtrimeve. Orët për ushtrime janë të një rëndësie të veçantë për përmbajtje të caktuara, për të cilat rekomandohet të përdoren ilustrime, animacione, modele, etj, gjatë realizimit të tyre.

Në realizimin e mësimin në bazë të programit të shkurtuar mësimor ,duhet të merren në konsideratë udhëzimet didaktike , dmth . format , metodat dhe aktivitetet e verifikuara në programin rregullt mësimor, të cilat janë të përfshira me njësitë mësimore të programit shkurtuar mësimor .

3. Normativi për kuadrin mësimor

Programin e shkurtuar mësimorë e realizon mësimdhënësi në pajtim me normativin për kuadrin mësimorë të përcaktuar në programin e rregullt mësimorë.

Programin e shkurtuar mësimorë për lëndën mësimore *kimi* për vitine IV- (katër) të arsimit të mesëm profesional me kohë zgjatje katërvjeçare në drejtimet **tekstil- lëkurë – për të gjithë profilet arsimore** për vitin shkollorë 2020/2021 e miratoi

Скратената наставна програма по наставниот предмет *хемија* за IV (четврта) година на средното стручно образование со четиригодишно траење на струка **текстилно-кожарска - сите образовни профили** за учебната 2020/21 година ја утврди

Министер за образование и наука,

Мила Царовска
